

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6765
E mërkurë, 23 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Rama: Të hyrat vetjake të Prishtinës i takojnë vetëm Prishtinës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ISH-KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ KA FOLUR TË MARTËN
PËR ZHVILLIMET NË VEND

HARADINAJ: SJELLJA E KURTIT, E RREZIKSHME



Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti arriti t'i dëmtojë marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në dhe me evropianët. Haradinaj, duke komentuar situatën e fundit në raport me zhvillimet në veri, ka theksuar se mospërfillja e kërkesës amerikane për shtyrjen e zbatimit të vendimit për targar, e ka sjellë situatën buzë shpërthimit. Sipas tij, sjellja dhe veprimet e kryeministrit Kurti, në raport me situatën e krijuar në vend, ka qenë jo vetëm e pakuptueshme, por edhe e rrezikshme

AKTUALE



**HOTI: SI DO TË ARSYETOHET
KRYEMINISTRI PËR 700 MILIONË
EURO QË I MBAN NË BANKË E NUK
I RRRIT PAGAT** F. 3

**ARTAN NIMANI LË POZITËN
E REKTORIT TË UNIVERSITETIT
"FEHMI AGANI"** F. 6

**ZPS-ja DORËZON LISTËN
ME 40 DËSHMITARËT E PARË NË
RASTIN THAÇI DHE TË TJERËT** F. 7

EKONOMI



**LULZIM RAFUNA ZGJEDHET
KRYESUES I BORDIT MENAXHUES
TË CIF-it** F. 8

**KURTI: REFORMA NË ADMINISTRATË
PUBLIKE, THELBËSORE NË
PROGRAMIN E QEVERISË SONË** F. 8

SPORT



**ARABIA SAUDITE 'SHOKON' ARGJENTINËN,
DANIMARKA NDALET NË BARAZIM** F. 10

PAS KËRKESËS SË SHBA-së, KURTI E SHTYN VENDIMIN PËR TARGAT



**KALON PROPOZIMI PËR
LIBERALIZIMIN E VIZAVE NË
JANAR TË VITIT 2024**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Irani nis pasurimin e uraniumit në 60 për qind

TEHRAN, 22 NËNTOR - Irani ka filluar pasurimin e uraniumit për 60 për qind në uzinën nëntokësore bërthamore Fordow, ka raportuar një medie shtetërore të martën. Ky veprim mund t'i zemërojë fuqitë perëndimore që po kërkonin nga Teherani zyrtar të tërhiqeshin nga planet nukleare duke e ringjallur marrëveshjen e vitit 2015. Irani tashmë është duke e pasuruar uraniumin në 60 për qind në objekte të tjera. Kjo përqindje është dukshëm nën 90-përqindëshin që kërkohet për materiale për armë, por është mbi 20-përqindëshin që prodhonte Irani para marrëveshjes së vitit 2015 me

fuqitë e mëdha. Kjo marrëveshje përcaktonte që uraniumi të mos pasurohej mbi 3.67 për qind. "Në një letër për Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore (IAEA), Irani e ka informuar agjencinë se ka filluar pasurimin e uraniumit në 60 për qind në uzinën Fordow duke përdorur centrifuga të avancuara IR-6", raportoi agjencia e lajmeve ISNA.

Bordi i Guvernatorëve i IAEA-s, që përbëhet nga përfaqësues të 35 vendeve, të martën e kaloi një rezolutë që urdhëron Iranin të bashkëpunojë urgjentisht me ekipin e agjencisë që po heton gjurmë të uraniumit në tri uzina të padeklaruara, thanë diplomatë

gjatë votimit prapa dyerve të mbyllura.

Agjencia e lajmeve, gjysmë-zyrtare, Fars, tha se Teherani ka filluar edhe procesin e "zëvendësimit të centrifugave të gjeneratës së parë (IR-1) me disa më të avancuara të tipit IR-6" në Fordow, një uzinë nëntokësore që ndodhet brenda një mali. Marrëveshja e vitit 2015 mes Iranit dhe gjashtë fuqive botërore ia lejon Iranit të përdorë vetëm centrifuga të gjeneratës së parë, IR-1. Por, pasi ish-presidenti i ShBA-së, Donald Trump, hoqi dorë nga kjo marrëveshje në vitin 2018, Teherani instaloi centrifuga më të avancuara dhe më efikase, si IR-2m, IR-4 dhe IR-6.



ShBA-ja dhe Rusia shtojnë presionin mbi Turqinë për kërcënimet ndaj Sirisë

UASHINGTON, 22 NËNTOR - Presioni ndërkombëtar u shtua të martën ndaj presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, me synimin për ta bindur të mos nisë një sulm tokësor kundër luftëtarëve kurdë në Siri.

Ankaraja ndërmori një seri sulmesh ajrore të dielën dhe goditi dhjetëra caqe ushtarake kurde në Irak dhe Siri, duke e quajtur këtë si operacion ushtarak për t'i "mposhtur terroristët".

Sulmet ajrore ndodhën pas hedhjes së një bombe në Stamboll që la gjashtë persona të vdekur dhe 81 të lënduar. Ankaraja zyrtare fajësoi Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), që është në listën e zezë të ShBA-së dhe BE-së si grup terrorist për sulmin.

Lideri turk ka kërcënuar që nga maji se do ta nisë një operacion të ri ushtarak në veri të Sirisë dhe i ka shtuar këto kërcënime pas sulmit të këtij muaji në Stamboll. "Nuk ka asnjë dyshim që ky operacion do të jetë i kufizuar në vetëm operacion ajror", tha Erdogan gjatë kthimit në Turqi pasi mori pjesë në hapjen e Kupës së Botës në Katar.



PKK-ja, që ka zhvilluar një kryengritje ndaj shtetit turk që nga viti 1984, mohoi të jetë përgjegjës për bombardimin e 13 nëntorit, i cili ishte më vdekjeprurës në pesë vjetët e fundit, pas një serie sulmesh në Turqi midis viteve 2015 dhe 2017.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkuan të hënën në mbrëmje të qetësohet situata që të "mbrohen

jetët e civilëve dhe ta përkrahim qëllimin e përbashkët për mposhtjen e ISIS-it", tha Ned Price, zëdhënës i Departamentit të Shtetit Amerikan, duke iu referuar luftës kundër Shtetit xhihadist Islamik (IS).

Ndërsa Rusia të martën tha se shpreson që Turqia do të jetë "e përmbytur" dhe nuk do të ketë "përdorim të tepruar të forcës" në

Siri. "Ne i kuptojmë dhe i respektojmë shqetësimet e Turqisë lidhur me sigurinë e saj. Ne prapë bëjmë thirrje për të gjithat palët që të përmbahen nga veprime që mund të çojnë në destabilizim serioz të situatës", tha zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov. Ndërkaq Alexander Lavrentyev, i dërguar i veçantë i presidentit rus Vladimir Putin në Siri, tha se

zyrtarët rusë shpresojnë "se do t'i bindim kolegët turq të përmbahen nga përdorimi i tepruar i forcës në territorin sirian". "Rusia ka muaj që ka bërë gjithçka të mundur që të parandalohet çfarëdo operacioni i madh tokësor", shtoi Lavrentyev.

Në këmbim, Turqia u ka kërkuar aleatëve të saj të mos i përkrahin luftëtarët nga Njësitë e Mbrojtjes së Popullit kurd (YPG), që ndihmuan në fushatën ushtarake të drejtuar nga ShBA-ja kundër IS-it. "Ne u tregojmë të gjithë bashkëbiseduesve, veçanërisht ShBA-së, se PKK-ja është e barabartë me YPG-në dhe se ne kërkojmë me ngulm që të ndalet plotësisht përkrahja e terroristëve", tha ministri i Mbrojtjes në Turqi, Hulusi Akar.

Turqia i ka kryer tri sulme në Siri që nga viti 2016, me qëllim mposhtjen e luftëtarëve kurdë sirianë, të cilët i akuzon se kanë lidhje me PKK-në.

Erdogani ka kërkuar disa herë që të krijohet një "zonë sigurie" prej 30 kilometrash për ta mbrojtur pjesën jugore të Turqisë nga sulmet kufitare nga territori sirian.

Vera e nxehtë në Francë mund të ketë shkaktuar 2 816 vdekje

PARIS, 22 NËNTOR - Tri valët e njëpasnjëshme të nxehtësisë, si dhe Covid-19, besohet të kenë shkaktuar mbi 10 mijë vdekje më shumë se zakonisht këtë verë në Francë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë të vendit. Gjithsej 10 420 vdekje më shumë sesa zakonisht u regjistruan gjatë periudhës mes 1 qershorit dhe 15 shtatorit në verën e dytë më të nxehtë të shënuar në Francë që nga viti 1900, sipas të dhënave nga Agjencia e Shëndetit Publik. Prej këtyre, 2 816 vdekje u regjistruan

gjatë tri periudhave kur pati nxehtësi ekstreme, nga 14 deri më 22 qershor, nga 9 deri më 27 korrik dhe nga 29 korriku deri më 14 gusht.

Të moshuarit ishin më të prekurit, pasi që personat mbi 75 vjeç përbëjnë 2 272 nga gjithsej 2 816 personat e vdekur gjatë valës së nxehtësisë. Shumicën e këtyre vdekjeve u shënuan në katër zona të Francës; Auvergne-Rhone-Alpes, Nouvelle Aquitaine, Occitane dhe Provence-Alpes-Cote d'Azur gjatë valës së të

nxehtëtit.

Pandemia Covid-19 besohet të ketë pasur rol edhe në vdekjet gjatë këtyre periudhave të të nxehtëtit, sipas agjencisë, pasi 894 vdekje shkaku i këtij virusi u regjistruan në spitale gjatë valëve të nxehtësisë. "Covid-19 mund t'i ketë bërë disa njerëz edhe më të ndjeshëm ndaj nxehtësisë dhe ekspozimit ndaj temperaturave të larta mund ta ketë përkeqësuar shëndetin e disa pacientëve me Covid-19", thanë nga agjencia e shëndetit publik në Francë.



Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka folur të martën për zhvillimet në vend

Haradinaj: Sjellja e Kurtit, e rrezikshme

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti arriti t'i dëmtojë marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në dhe me evropianët. Haradinaj, duke komentuar situatën e fundit në raport me zhvillimet në veri, ka theksuar se mospërfillja e kërkesës amerikane për shtyrjen e zbatimit të vendimit për targarat, e ka sjellë situatën buzë shpërthimit. Sipas tij, sjellja dhe veprimet e kryeministrit Kurti, në raport me situatën e krijuar në vend, ka qenë jo vetëm e pakuptueshme, por edhe e rrezikshme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar pas mosarritjes së marrëveshjes për targarat në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Haradinaj ka thënë se sjellja dhe veprimet e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në raport me situatën e krijuar në vend, gjatë gjithë këtyre ditëve, ka qenë jo vetëm e pakuptueshme, por edhe e rrezikshme. "Mospërfillja e kërkesës amerikane për shtyrjen e zbatimit të vendimit për targarat e ka sjellë situatën buzë shpërthimit.

Kemi ardhur në një situatë që do të mund t'i rrezikonim jetët e qytetarëve të Kosovës, por edhe të policëve. E gjithë kjo për arsye krejt të paqëndrueshme, për ta kthyer situatën e para një muaji, ku kursi i gabuar që kishte zgjedhur kryeministri, ka shkaktuar dëme të mëdha, duke asgjësuar një punë të jashtëzakonshme që ishte bërë

gjatë gjithë këtyre viteve për integrimin e serbëve në institucionet e vendit", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se e kupton sjelljen e plot kundërshtarëve politikë të kryeministrit Kurti që i gëzohen fundosjes politike të tij, por Haradinaj ka thënë se është shqetësuar jo për dështimin e kryeministrit, por për dështimin e të gjithë neve si Kosovë. "Jam tejet i shqetësuar me faktin se sot në sytë e BE-së dhe të ShBA-së, Kosova, nga viktimë, është shndërruar në fajtorë për situatën e krijuar, ndërsa Serbia është shndërruar në partnere konstruktive. Fajtori i vetëm për këtë gjendje të krijuar e ka vetëm një emër. Ai është Albin Kurti. Kurti arriti t'i dëmtojë marrëdhëniet e Kosovës edhe me ShBA-në edhe me evropianët; Kurti arriti ta heqë nga tavolina draftin dhe përpjekjen për të arritur marrëveshje përfundimtare për njohje me Serbinë; Kurti arriti ta vendosë populizmin dhe egoizmin e tij mbi interesat e shtetit të Kosovës; Kurti arriti ta



nxjerrë veriun nga kontrolli i Kosovës", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Kurti arriti ta kthejë shtetin e Kosovës në shtetin e një individi që vetë vendos dhe vetë vulos. "Kurti arriti t'i rikthejë tensionet për të cilat askush nuk mund ta parashikojë fundin. Kurti arriti ta çojë Kosovën në prag të ndarjes së veriut nga pjesa tjetër e

shtetit. Dhe, në fund, Kurti arriti ta dëmtojë rëndë imazhin e Kosovës demokratike, multietnike, të përgjegjshme dhe që merr vendime të bashkërenduara me partnerët ndërkombëtarë duke e kthyer nga kontribuues të stabilitetit në rajon, në element destabilizues", është shprehur Haradinaj, duke theksuar se gjendja është kjo që

është. "Albin Kurti sot e ka vetëm një rrugë, që është bashkëpunimi i ngushtë e pa kushte me partnerët tanë, posaçërisht me ShBA-në. Dhe këtë duhet ta bëjë jo për vete dhe qeverinë e tij, por për vendin, sigurinë e të cilit sot është më e rrezikuar se asnjëherë më parë", ka deklaruar ish-kryeministri Haradinaj.

Hoti: Si do të arsyetohet kryeministri për 700 milionë euro që i mban në bankë e nuk i rrit pagat

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se takimet publike për buxhetin e vitit 2023, të cilat qeveria paska filluar t'i mbajë nëpër qytete, janë farsë. Sipas tij, konsultimet për buxhetin zakonisht mbahen para përgatitjes së buxhetit. "Konsultime për buxhet do të duhej të mbaheshin me biznese për mosrealizimin e investimeve kapitale. Konsultime do të duhej të mbaheshin me kryetarët e komunave për nevojat e tyre, të cilëve qeveria po tenton t'ua marrë buxhetin nga të hyrat vetjake të viteve paraprake. Para përgatitjes së buxhetit do duhej të bisedohej me organizata buxhetore të cilat, për shkak të shkurtimeve buxhetore, nuk kanë mundësi t'i ofrojnë shërbimet për të cilat janë të mandatuar, siç është rasti i RTK-

së apo i universiteteve publike", është shprehur Hoti.

Ai ka theksuar se si do të arsyetohet kryeministri para qytetarëve për afër 700 milionë euro që i mban në bankë pa nevojë e nuk i rrit pagat e policëve, të mjekëve, të arsimtarëve, të shërbyesve civilë etj., të cilëve u janë zvogëluar pagat për 20 për qind për shkak të inflacionit. "Si do të arsyetohet ministri i Financave për 276 mil euro apo 9 për qind e buxhetit total për 2023, të cilën shumë e mban të paspërndarë në projekte, që është sa dyfishi i buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes?! Si do të arsyetohen qeveritarët që sivjet nuk i realizuan projektet kapitale - as projektet në vazhdim e as të rejtat që ishin projekte që vetë i planifikuan?!", ka shkruar Hoti në "Facebook".





Pas kërkesës së ShBA-së, Kurti e shtyn vendimin për targat

Me kërkesë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të hënën pas mesnate vendosi ta shtyjë për 48 orë zbatimin e fazës së dytë të vendimit për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës. Faza e dytë ka paraparë shqiptimin e gjobave prej 150 eurosh për qytetarët që qarkullojnë me targa të tilla

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shtyrë për 48 orë zbatimin e fazës së dytë të vendimit për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës. Faza e dytë ka paraparë shqiptimin e gjobave prej 150 eurosh për qytetarët që qarkullojnë me targa të tilla. Kërkesën për shtyrje 48-orëshe e ka bërë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se Shtetet e Bashkuara i kanë kërkuar Qeverisë së Kosovës ta shtyjë për 48 orë vendimin për shqiptimin e gjobave, për t'i lejuar zyrtarët evropianë dhe ata amerikanë që të angazhohen me Kosovën dhe Serbinë për të gjetur zgjidhje për këtë çështje. Si përgjigje ndaj kërkesës së ambasadorit amerikan, Kurti ka thënë se është i gatshëm të punojë me ShBA-në dhe BE-në për të gjetur zgjidhje në dy ditët e

ardhshme.

Departamenti Amerikan i Shtetit është shprehur i zhgënjyer për mosarritjen e një marrëveshjeje në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit serb Aleksandar Vuçiq, për këtë çështje, pas takimit disaorësh që kanë zhvilluar më 21 nëntor në Bruksel nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Kurti dhe Vuçiqi "duhet të bëjnë koncesione për të siguruar që nuk rrezikojnë paqen e arritur me vështirësi në një rajon veçse të brishtë", ka thënë zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price.

Zhënjim për mosarritje të marrëveshjes kanë shprehur edhe Bashkimi Evropian, Mbretëria e Bashkuar dhe NATO-ja.

Takimi i 21 nëntorit në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE), ka përfunduar pa marrëveshje. Ndërmjetësuesi i këtij takimi, Josep Borrell, ka thënë se Kurti

nuk e ka pranuar propozimin e BE-së për targat, ndërsa Vuçiqi është pajtuar me këtë propozim. "Për hir të transparencës, ne parashtruan një propozim që mund ta shmangte këtë situatë të rrezikshme. Presidenti Vuçiq e pranoi por, për fat të keq,

kryeministri Kurti nuk e pranoi" ka deklaruar Borrelli, duke i bërë thirrje Kosovës që ta pranojë propozimin e BE-së për targat. Ndërsa kryeministri Albin Kurti e ka akuzuar Borrellin për heqjen dorë nga marrëveshja e madhe. Edhe presidentja Osmani ka kritikuar zyrtarin e lartë të BE-së, Josep Borrell, për qasjen ndaj dialogut. "Rregulli i parë i secilit proces ndërmjetësues është paanshmëria. Ajo që pamë sot nga z. Borrell ishte njëanshmëri e shpërfaqur haptazi, akomodim i

agresorit dhe prezantim i një realiteti tërësisht të shtrembëruar", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Presidentja Osmani ia ka kujtuar Borrellit 15 marrëveshjet që Serbia i ka shkelur. "Paqja dhe stabiliteti nuk mund të arrihen duke akomoduar ata që kanë ambicie hegemoniste, por Kosova asnjëherë nuk do të heqë dorë nga qëllimi i qartë për paqe e stabilitet afatgjatë si dhe rend e ligj në tërë territorin e saj", ka theksuar Osmani.

"E përsëris, është absurde që të rrezikohet përshkallëzimi i situatës për shkak të targave", ka thënë ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde. Ai ka shkruar në "Twitter" se është mirë që përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajčak, ka më shumë kohë që të punojë me palët për të gjetur një zgjidhje.

Edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka shprehur zhgënjimin e tij për mosarritjen e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë për çështjen e targave dhe ka thënë se misioni i aleancës veriatlantike në Kosovë, KFOR, vazhdon të jetë vigjilent. "Tani është koha për përgjegjësi dhe zgjidhje pragmatike. Përshkallëzimi duhet të shmanget", ka thënë Stoltenbergu përmes një postimi

Komandanti i KFOR-it diskuton me Sveçlën për situatën e sigurisë

Komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, gjenerali Angelo Michele Ristuccia, është takuar me ministrin e Brendshëm, Xhelal Sveçla, për të diskutuar për situatën aktuale në Kosovë dhe tensionet e krijuara për shkak të mosarritjes së marrëveshjes mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandar Vuçiq në Bruksel për çështjen e targave. "Komandanti u ka bërë thirrje të gjitha palëve që të shmangin

çfarëdo veprimi që mund të çojë në përkeqësim të situatës. Ai u ka bërë thirrje palëve që të veprojnë me përgjegjësi dhe të ketë rol aktiv në garantim të sigurisë", thuhet në deklaratën e KFOR-it, duke theksuar se gjenerali Ristuccia vazhdon të jetë në kontakt të ngushtë me të gjithë ndërmjetësuesit, përfshirë komandantin e misionit të BE-së për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX), me përfaqësues të autoriteteve në Kosovë dhe atyre në Serbi.

Rama: Të hyrat vetjake të Prishtinës i takojnë vetëm Prishtinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar ndaj miratimit të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2023 në mënyrë specifike, pjesën e paragrafit 6 të nenit 9 i cili përcakton se: "Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022 dhe të pashpenzuara bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar".

Rama ka theksuar se të hyrat vetjake të Prishtinës i takojnë vetëm Prishtinës. "Në emër të kryeqytetit dhe qytetarëve të tij dua ta shpreh shqetësimin e thellë lidhur me tendencën e

Qeverisë së Republikës së Kosovës për t'i ridestinuuar mjetet financiare nga buxheti i kryeqytetit. Në mënyrë specifike e kundërshtojmë fuqishëm pjesën e paragrafit 6 të nenit 9 të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2023 i cili përcakton se: "Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022 dhe të pashpenzuara bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar". Miratimi i Projektligjit për Buxhetin e vitit 2023 në këtë formë do të paraqesë shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 124, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, specifikon se "Komunat kanë të drejtë të vendosin, të

caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore në pajtim me ligjin". Për më tepër, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, neni 2, Pavarësia Financiare e Komunave, pika 2.3, parasheh që "Për të mirë të popullsisë së komunës, Kuvendi Komunal dhe zyrtarët ekzekutivë kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetjake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm". Unë si kryetar i kryeqytetit, i zgjedhur për të përfaqësuar dhe mbrojtur

interesin e qytetarëve të Prishtinës, jam i obliguar të siguroj që të hyrat e tyre të kthehen në investime zhvillimore për Prishtinën. Në këtë rast, janë rreth 38 milionë euro të hyra vetjake të mbledhura nga qytetarët e Prishtinës, të cilat nuk mund të tjetërsohen për t'ua shpërndarë institucioneve dhe komunave të tjera", ka thënë Rama.

Duke rikujtuar se Prishtina çdo ditë frekuentohet nga dhjetëra mijëra qytetarë të komunave të tjera të Kosovës duke ngarkuar infrastrukturën e saj në mënyrë të vazhdueshme. "Nëse Projektligji për Buxhetin e vitit 2023 miratohet në formën aktuale do

ta dëmtojë rëndë zhvillimin e projekteve të kryeqytetit të cilat i gëzojnë edhe qytetarët e komunave të tjera. Unë u bëj thirrje deputetëve të respektojnë Kuvendin të Republikës së Kosovës t'i mbrojnë interesat e kryeqytetit ku jetojnë dhe veprojnë edhe një numër i madh i qytetarëve nga e gjithë Kosova. Unë ju bëj thirrje që të angazhoheni dhe votoni për ta fshirë fjalinë e paragrafit 6 të nenit 9 të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2023 i cili përcakton se: "Të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit fiskal 2022 dhe të pashpenzuara bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar", ka deklaruar Rama.

në "Twitter" pas bisedës që ka zhvilluar me kryediplotmatin e Bashkimit Evropian, Josep Borell. Shqiptimi i gjobës është pjesë e vendimit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Faza e parë ka paraparë qortimin, e dyta parashihet të vendosen disa targa provuese. Sipas vendimit të qeverisë, pas 21 prillit në Kosovë nuk duhet të ketë më makina me

targa të tilla që lëshojnë autoritetet serbe.

Serbia - e cila lëshon targa të paligjshme për serbët e Kosovës që nga paslufta më 1999, e kundërshton këtë plan - duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Si pasojë e tensioneve të ngritura, serbët e veriut të Kosovës - ku qarkullojnë kryesisht makinat me targa të paligjshme - kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës.

Një veturë me targa të Serbisë është djegur të hënën pas mesnate në veri të Mitrovicës. Kështu ka bërë me dije drejtori i Policisë për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Besim Hoti. "Ngjarja ka ndodhur në orën 02:05 të mëngjesit", tha ai.

Hoti shtoi se janë duke u zhvilluar hetime lidhur me rastin. Më herët në veri të Kosovës janë djegur edhe vetura me targa RKS në pronësi të qytetarëve serbë që jetojnë atje.

KMDLNj: Askujt nuk i duhet përshkallëzimi i situatës

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar për mosarritjen e marrëveshjes për targa në Bruksel. Duke e parë situatën pas dështimit të kësaj marrëveshjeje, KMDLNj ka theksuar se askujt nuk i duhet përshkallëzimi i situatës në veri. KMDLNj mendon se nëse nuk i luhet ndonjë lojë prapa krahëve Kosovës, në veri nuk do të ketë përshkallëzim të dhunshëm të situatës që do ta rrezikonte sigurinë dhe se shpejt do të materializohet një marrëveshje e cila ndihmon në tejkalimin e gjendjes dhe tensioneve.

U jepet vërejtje marketeve në Podujevë për vendosjen e flamujve të origjinës së produktit

PODUJEVË, 22 NËNTOR - Drejtorja e Inspeksionit në Podujevë nga data 9 nëntor deri më 21 nëntor ka zhvilluar kontrolle në 39 markete të mëdha e të mesme në komunën e Podujevës. Gjatë kontrolleve janë monitoruar se a përputhen çmimet e ekspozuara me çmimet në

arkë, afatin e skadencës së produkteve dhe vendosjen e flamujve të origjinës së produkteve.

Gjatë kontrolleve inspektorati komunal i tregut ka shqiptuar mbi 20 vërejtje për marketet për vendosjen e flamujve të origjinës së produktit dhe ka hasur në nëntë markete

produkte me afat të skaduar, asgjësimi i të cilave është bërë. Bazuar në kompetencat e saj, Drejtorja e Inspeksionit ka njoftuar se do t'i vazhdojë kontrollet e rregullta, me qëllim të ruajtjes së konsumatorit nga manipulimet me çmime dhe nga produktet me afat të skaduar.



Vazhdon me intensitet të lartë realizimi i projekteve kapitale në Prizren

PRIZREN, 22 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka mbajtur mbledhjen e përvajshme me drejtorët, ku është raportuar për arritjet javore dhe planifikimin për ditët në vazhdim. Situata aktualisht është nën kontroll në gjithë komunën e Prizrenit. Është themeluar edhe Shtabi Emergjent i cili mund të kontaktohet 24/7 për çdo problem në terren që mund të shkakatohet nga reshjet.

Me prioritet, në këtë mbledhje, kryetari Totaj ka kërkuar fillimin sa më të shpejtë të projektit të futjes së kabllove elektrike nën tokë dhe rregullimin e kalldrëmeve në Shatërvan si dhe furnizimin e familjeve në nevojë me lëndë djegëse për sezonin e ftohtë.

U theksua se javën që po lëmë pas ka vazhduar me intensitet të lartë realizimi i projekteve kapitale në komunën e Prizrenit, ndërsa së

shpejti fillon rregullimi i komplet infrastrukturës (kanalizim, ndriçim dhe asfaltim) në lagjen "Dardania" në Prizren. Gjithashtu, ka filluar kontrollimi i dokumenteve të lejeve të ndërtimit të sallave të dasmave dhe të vilave për përputhshmërinë e lejeve me ndërtimin në terren, ku do të merren masa nëse nuk ekziston harmoni mes dokumenteve dhe gjendjes në lokacionet e caktuara. Po ashtu, u bë me dije se gjatë javës që lamë pas kanë vazhduar aksionet e inspektorëve komunalë për lirim të hapësirave publike dhe trotuareve si dhe do të inspektohen lejet mjedisore për antenat e telefonive mbi ndërtesa. Inspektorët, gjithashtu, kanë filluar kontrollimin e taksive me qëllim të shpejtimit të qarkullimit të automjeteve në rrugët komunale.



Artan Nimani lë pozitën e rektorit të Universitetit "Fehmi Agani"



GJAKOVË, 22 NËNTOR - Artan Nimani ka njoftuar se nuk do të jetë më rektor i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë. Ai ka falënderuar kolektivin universitar, duke vlerësuar për bashkëpunim stafin profesional dhe studentët në këtë universitet. "Sot po largohem si Rektor i Universitetit 'Fehmi Agani' Gjakovë. Por së pari, dua të falënderoj komunitetin tonë universitar. Unë e kam vlerësuar gjithmonë qëndrimin e kolegëve të fakultetit, stafit profesional dhe studentëve tanë punëtorë dhe u jam mirënjohës për mbështetjen e gjerë që gëzon tani universiteti ynë.

U jam mirënjohës të gjithë juve, studentë, profesorë, administratë dhe ekipit tim, pa të cilët nuk do të mund të ishim në rrugën tonë për të qenë një universitet publik i suksesshëm. Jam krenar ku jemi sot si universitet dhe çfarë kemi arritur së bashku në tre vitet e fundit që kur jam emëruar rektor. Unë synoj t'i rikthehem detyrës time të parë profesionale si profesor. Ka qenë me të vërtetë nder i jetës që të përfaqësoja komunitetin tonë dhe që të ndihmoja në ndërtimin e Universitetit 'Fehmi Agani' Gjakovë", ka shkruar Nimani.

Në Mitrovicë situata nga reshjet e shiut është stabile

MITROVICË, 22 NËNTOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me drejtorët e drejtorive përgjegjëse dhe operatorët e kontraktuar, kanë dalë në terren, konkretisht në dy lagje në Vaganicë, për të vlerësuar gjendjen e rrugëve pas reshjeve të vazhdueshme të shiut.

Gjatë inspektimit është vlerësuar se situata pas reshjeve të shiut është stabile, nuk qëndron e rënduar dhe ka rënie të nivelit të ujit. Lidhur me këtë kryetari Hamza ka falënderuar edhe kompanitë lokale dhe ekipet emergjente për intervenimet e menjëhershme në ato lokalitete ku reziku për të

shkaktuar dëme ka qenë i mundshëm.

Drejtoritë përgjegjëse gjatë gjithë kohës janë në monitorim të situatës, ndërkohë që operatorët dhe shërbimet përkatëse në çdo moment janë në gjendje gatishmërie për të intervenuar me çdo vështirësi që qytetarët mund të përballen.



ZPS-ja dorëzon listën me 40 dëshmitarët e parë në rastin Taçi dhe të tjerët

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dorëzuar listën e përkohshme të 40 dëshmitarëve të parë të saj në rastin ndaj Hashim Taçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. "Në bazë të urdhrave, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) paraqet një listë të përkohshme të 40 dëshmitarëve të parë që do të thirren në gjyq dhe si të rëndësishme për këta dëshmitarë, deklaratat që synon të kërkojë t'i pranojë në përputhje me Rregullën 154",

është thënë në shkresën e ZPS-së.

Po ashtu, është thënë se duke marrë parasysh natyrën e përkohshme të kësaj liste dhe fazën e procedurës, lista mbetet në shqyrtim dhe mund të nevojiten rregullime si për dëshmitarët ashtu edhe për deklaratat.

Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Taçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me

akuza, ku këta të fundit ngarkohen për krime lufte e krime kundër njerëzimit, pasi që gjykatësi e kishte aprovuar pjesërisht mocionin e mbrojtjes së Hashim Taçit, të parashtruar ndaj aktakuzës së ndryshuar në rastin ku ai me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin po akuzohen për krime lufte dhe ZPS-ja ishte urdhëruar të bëjë ndryshime në aktakuzën e ndryshuar.

Të gjitha këto akuza janë mohuar nga Hashim Taçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.



Kalon propozimi për liberalizimin e vizave në janar të vitit 2024

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Përfaqësues të vendeve anëtare të BE-së u pajtuan me propozimin që liberalizimi i vizave për Kosovën të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024. "Radio Evropa e Lirë" merr vesh se pajtimi u arrit në një takim të këshilltarëve për viza të martën në Bruksel. Kjo datë ishte kërkesë e Spanjës - njërit prej pesë vendeve të BE-së që nuk e njeh ende pavarësinë e Kosovës.

Paraprakisht, Republika Çeke - e cila aktualisht udhëheq presidencën gjashtëmujore të BE-së - kërkoj që liberalizimi i vizave për Kosovën të fuqizohet më 1 dhjetor të vitit 2023. Por, ky propozim nuk kaloi në një takim të grupit punues të BE-së për vizat, që u mbajt javën e kaluar, pasi Spanja e më pas edhe Sllovakia dhe Suedia paraqitën vërejtje dhe kërkuar, siç thanë, sqarime shtesë. Arsyet e tyre nuk u bënë të qarta.

Sipas propozimit të miratuar të martën, "hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të nisë në kohën kur të jetë funksional sistemi i udhëtimit ETIAS, por jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024".

Miratimi i këtij propozimi do të jetë në rend dite në takimin e ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së që do të mbahet të mërkurën.

Liberalizimi i vizave do t'u



mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane.

Diplomatë të BE-së thonë se kalimi i propozimit është një gjë pozitive, sepse ekziston një datë konkrete për hyrjen në fuqi të liberalizimit të vizave. Sipas tyre, nëse ETIAS bëhet funksional sipas pritjeve, përkatësisht në nëntor të vitit të ardhshëm, liberalizimi i vizave mund të hyjë

në fuqi edhe më herët, më 1 nëntor 2023.

Lidhja me sistemin ETIAS

ETIAS është një sistem digjital që synon ta bëjë evidentimin e vizitorëve që hyjnë prej jashtë BE-së në zonën Schengen. Ky sistem është dashur të nisë së funksionuar në vitin 2022, por data është shtyrë disa herë dhe tani si afat përmendet nëntori i vitit 2023.

Në një takim të grupit punues për viza të Këshillit të BE-së, të mbajtur më 13 tetor, zyrtarët francezë propozuan që liberalizimi i vizave për Kosovën të lidhet pikërisht me funksionalizimin e ETIAS-it. Republika Çeke doli më pas me propozimin që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave të lidhej me funksionalizimin e ETIAS-it por, njëherësh, të caktohej edhe data e fuqizimit të vendimit: "jo më vonë se 1 dhjetori i vitit 2023".

Me kërkesën e Spanjës kjo datë u shty për 1 janar të vitit 2024.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në zonën Schengen. Kjo, me gjithë faktin se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezervë.

Në Athinë diskutohet për sigurinë e energjisë

ATHINË, 22 NËNTOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, me ftesë të ministrit grek për Energji dhe Mjedis, Kostas Skrekas ka marrë pjesë në dialogun e parë ministror të energjisë në Athinë me temën "Garantimi i sigurisë energjetike në një botë në zhvillim".

Në takimin ministror, krahas ministres Rizvanolli dhe ministrit Srekas, kanë marrë pjesë ministrja e Shqipërisë, Belinda Balluku, ministri i Bullgarisë,

Rosen Hristov, ministri i Italisë, Gilberto Pichetto Fratin, si dhe ministri i Rumanisë, Virgil-Daniel Popescu.

Gjatë takimit ministrat kanë diskutuar rreth shtrirjes dhe zgjerimit të lidhjeve të transmisionit, rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtërishe të energjisë në miksin e energjisë të vendeve të Evropës jug-lindore si dhe rritjes së efikasitetit të energjisë si një ndër hapat kyç në përballje me

krizën energjetike evropiane.

Ministrja Rizvanolli gjatë diskutimit me ministra ka cekur që siguria e energjisë mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit të ngushtë në të cilin varen pavarësia dhe siguria energjetike e Evropës.

Është kritikë që ky bashkëpunim të ndërtohet jo vetëm duke u bazuar në zhvillim ekonomik, por në vlerat tona të përbashkëta evropiane, të paqes e demokracisë.



Lulzim Rafuna zgjedhet kryesues i Bordit Menaxhues të CIF-it

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, është zgjedhur kryetar i Bordit Menaxhues të Forumit të Investimeve të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor (Western Balkans 6 Chamber Investment Forum - WB6 CIF). Duke e marrë detyrën e re, Rafuna u shpreh falënderues për besimin e dhënë dhe u zotua për përkrahje për eliminimin e mëtutjeshëm të barrierave mes bizneseve.

“Faleminderit për besimin e dhënë për të udhëhequr një

mekanizëm kaq të rëndësishëm! I rëndësishëm sepse qëllim kryesor e ka përkrahjen e bizneseve në të bërit biznes në rajon, me shumë fitime dhe rritje të punësimit. Do të vazhdojmë edhe më shumë t'i përkrahim bizneset duke eliminuar barrierat administrative dhe joadministrative. Nuk do të jete e lehtë, po nuk është e pamundur”, ka theksuar Rafuna në cilësinë e kryesuesit të ri të Bordit Menaxhues

Kjo është hera e parë që Kosova

merr kryesimin e Bordit Menaxhues të CIF-it.

Forum i Investimeve i Dhomave të Ballkanit Perëndimor 6 është nismë e dhomave nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia, për një platformë bashkëpunimi, e ndërmarrë në vitin 2017, e që synon të ofrojë një zë të përbashkët të komunitetit të biznesit në rajon si dhe t'i lehtësojë kontaktet ndërbiznesore dhe ta promovojë rajonin si një destinacion investimi.



Kurti: Reforma në administratë publike, thelbësore në programin e qeverisë sonë



PRISHTINË, 22 NËNTOR - “Reforma në administratë publike është pjesë thelbësore e reformave të planifikuara në programin e qeverisë sonë. Është besim e qëndrim yni se një administratë publike besnike ndaj shtetit, e ndershme, e shkolluar dhe e përgatitur, me efikasitet më të lartë, është parakusht për politika të përmbushura zhvillimore”, u shpreh kryeministri Albin Kurti në konferencën vjetore të organizuar nga Ambasada

Britanike në kuadër të projektit “Rekrutimi i pavarur, i përgjegjshëm, meritokratik dhe profesional në Kosovë”. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti ka theksuar se reformimi i administratës publike është edhe parakusht për hapat avancues të Republikës së Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ai ka thënë se qeveria është e përkushtuar që reforma, rrjedhimisht administrata që po ndërtojmë, të jenë të bazuara mbi disa parime që

respektohen gjerësisht nga vendet demokratike dhe të zhvilluara. “Një administratë joefikase shkakton ngecje më pastaj në ofrimin e shërbimeve publike për nga cilësia, për nga sasia, shkakton gjithashtu edhe ngecje në zhvillimin e proceseve të reformave në sektorët e tjerë”, ka thënë Kurti, duke shtuar se qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë për t'i adresuar sfidat dhe problemet me të cilat përballet administrata dhe qytetarët kur kanë nevojë të kenë

ndërveprim me të. Kurti ka veçuar dokumentet strategjike që trajtojnë këto çështje. “Plani për zhvillim kombëtar, bashkimi i tri strategjive për administratë publike në një të vetme dhe hartimi i saj për periudhën 2022-2027, hartimi i strategjisë për e-qeverisje e hartimi i strategjisë për siguri kibernetike janë veprime esenciale të cilat tashmë i kemi ndërmarrë”, është shprehur ai. Kryeministri ka theksuar se Ministria e Punëve të

Brendshme ka rishikuar rëndësisht Ligjin për Zyrat e Publikë dhe ka hartuar nga fillimi Ligjin për Paga në sektorin publik për t'iu përshtatur aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ai ka falënderuar të gjithë partnerët që janë duke përkrahur qeverinë për këto reforma përmes projekteve të ekspertizës, duke shtuar se bashkëpunimi është komponentë shumë e rëndësishme në gjithë këtë proces.

Përfaqësues nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë vizitojnë ATK-në

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka pritur në takim Diar Seckinger, shef i Njësisë Ekonomike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë me ekipin e tij si dhe Dardana Peja nga USAID-i. Sipas njoftimit të ATK-së, takimi ishte në frymën e bashkëpunimit dhe

mbështetjen e vazhdueshme që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes projekteve të ndryshme, i ka ofruar ATK-së për reformimin e shumë proceseve të cilat kanë dhënë rezultate të jashtëzakonshme në performancën e ATK-së. Ajo çfarë u diskutua në këtë takim ishte trendi i inkasimit të të hyrave tatimore, për të cilat u njoftuan rreth

faktorëve që kanë ndikuar në rritjen prej 28-përqindësh të të hyrave tatimore në vitin 2021, respektivisht rritjes prej 22-përqindësh në dhjetëmujorin e vitit 2022, të cilat rezultate janë më të larta që nga themelimi i institucionit tatimor. Po ashtu, u diskutua edhe për pritjet lidhur me vazhdimin e trendit rritës në vitet 2023 dhe 2024.



Kush e sundon botën? Milingonat...



Nga Farhad MANJOO

Në shtator, shkencëtarët në Universitetin e Hong Kongut publikuan regjistrimin më të plotë të milingonave të realizuar ndonjëherë. Shifra është aq e madhe saqë duket si e sajuar. Studimi vlerësoi se në Tokë ka të paktën 20 kuadrilion – pra 20.000.000.000.000.000 milingona në Tokë.

Ose rreth 2.5 milionë milingona për çdo qenie njerëzore. Dhe për shkak se studimi u mbështet në një vlerësim konservator për milingonat që jetojnë në pemë dhe nuk përfshin milingonat që jetojnë nëntokë, atëherë numri në total është shumë herë më i madh. “Nuk do të habitësia nëse do të ishte diçka e tillë”- thotë Sabin Noten, një nga autorët e studimit. Këto shifra më bëjnë shumë përshtypje. Ashtu si çdo fëmijë, edhe unë kam qenë e fiksuar pas milingonave.

Kam kaluar pasdite të pafundme vere në oborrin e shtëpisë duke vëzhguar misterin dhe madhështinë e jetës së milingonave. Sa e pabesueshme ishte ajo, sa në mënyrë elegante organizoheshin dhe sa të zëna ishin që të gjitha me punë. Ajo që më ka bërë gjithmonë përshtypje është ngjashmëria e tyre e madhe me njerëzimin.

Ata jetojnë në shoqëri, të gjitha e kanë një punë, angazhohen në udhëtime të vështira të përditshme për në punë. Por ka

kaq shumë gjëra nga jeta e milingonave që nuk kanë kuptim për ne: është vetëmohimi i madh, dhe nënshtrimi i individit ndaj kolektivit.

Tek kolonitë e milingonave ka mungesë të ndonjë lloj liderशिप apo koordinimi, dhe jeta e tyre diktohet nga instinkti dhe algoritmi, që buron nga inteligjenca kolektive. Kjo është mënyra se si ato lëvizin dhe komunikojnë përmes sinjaleve kimike, duke krijuar shenja rrugore nga feromonet dhe duke mos ngecur kurrë të bllokuara në një vend.

Por regjistrimi më i nxitë të mënyrë që nuk e kisha bërë më parë. Pra si për një specie sociale jo thjesht tejet e ndryshme nga e jona, por që është në shumë mënyra pa diskutim superiore ndaj njeriut. Unë vazhdoj të mendoj se milingonat janë një shembull të cilin njerëzimi duhet të ndjekë.

Gjatë dhjetëra miliona viteve të evolucionit, milingonat e kanë kuptuar se si të shtohen në numër pa e varfëruar botën përreth tyre. Në fakt, e kundërta është e vërtetë: Për shkak se ato ofrojnë shumë funksione të rëndësishme për habitatet e tyre, ato janë “gjërat e vogla që drejtojnë botën”, siç shkroi dikur sociobiologu i njohur E.O. Uillson për milingonat dhe jo-vertebrorët e tjerë.

Si njerëz është e natyrshme, që të fokusohemi tek të menduarit e

specieve tona si disi të veçanta. Megjithatë, bazuar në shumë parametra objektivë, milingonat janë shumë më të rëndësishme për jetën në Tokë sesa ne. Uillson shkroi se nëse njerëzit do të zhdukeshin, pak gjëra në botë do të ndryshonin.

Por po të zhduken milingonat dhe jo-vertebrorët e tjerë, pothuajse gjithçka do të shkonte keq. Milingonat ajrosin tokën, transportojnë farat dhe ndihmojnë në procesin e dekompozimit. Tumat e tyre shërbejnë si oaze të dendura lëndësh ushqyese që janë një themel për një gamë të gjerë të jetës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në jetën në planet, për të mos përmendur popullsinë e tyre të madhe, a mos duhet të mendojmë më shumë për milingonat? Ato janë ndër format më të sofistikuar dhe më të suksesshme të jetës që kanë ekzistuar ndonjëherë në Tokë.

Natyrisht njerëzit janë më të zgjuar dhe më të mëdhenj sesa milingonat. Dhe gjatë 300.000 viteve të fundit të mbretërimit të specieve tona, ne e kemi pushtuar planetin dhe kemi vënë nën kontroll burimet e tij në një shkallë ndoshta të pakrahueshme në historinë e jetës në këtë planet.

Por krahasuar me ato të milingonave dhe insekteve të tjera sociale – bletëve, termiteteve dhe disa llojeve të grerëzave – rekordi ynë është i

papërfillshëm. Milingonat kanë ekzistuar prej të paktën 140 milionë vjetësh. Ato janë një tipar dominues – shpeshherë inxhinieret kryesore të ekosistemit – të pothuajse çdo ekosistemi në Tokë.

Milingonat janë angazhuar në kultivimin e bimëve për të paktën 60 milionë vjet. Për shembull milingonat gjetheprerëse, ushqehen me foragjere për bimësi, të cilën e përdorin për të rritur të korrat e një kërpudhe, të cilën e kanë zbutur për përdorimin e tyre vetjak.

Po ashtu, milingonat janë arkitekte mjeshtrë, luftëtare të frikshme, por që gjithashtu mund të ruajnë paqen përmes forcës dhe madje të përfshihen në kompromis dhe në një lloj “demokracie”. Milingonat nuk janë gjithmonë fqinjë të mirë.

Por edhe kur ato janë shkatërrues në aspektin ekologjik, kanë shumë për të na mësuar rreth bashkëpunimit. Gjatë shekullit të kaluar, milingona argentinase, një specie pushtuese që udhëtonte me njerëzit për t’u përhapur nga Amerika e Jugut në pjesën më të madhe të botës, e ka dominuar globin duke formuar një strukturë organizative befasuese dhe ndoshta të re evolucionarist, super-koloninë. Këto janë koloni masive milingonash, në të cilat individët përzihen lirshëm midis foleve të ndryshme të përhapura në distanca të mëdha. Milingonat e

bëjnë këtë sepse në përshtatjen në tokat e tyre të reja, ato e reduktuan ndjeshëm agresivitetin e tyre, duke lejuar ekzistencën e grupimeve shumë më të mëdha.

Një super-koloni e milingonave argentinase shtrihet rreth 6500 km milje nga Italia në Spanjë. Ajo është “njësia më e madhe bashkëpunuese e regjistruar ndonjëherë”, sa për të cituar një studim. Ky lloj dinamizmi social, është një pjesë kyçe e suksesit të milingonave. Është e vështirë të imagjinohet që pas disa miliona vitesh, njerëzit do të jenë ende ndër format e jetës dominuese të planetit. Po milingonat? Lëndët e tyre me siguri do të rezistojnë.

Në një studim të botuar këtë vit, ekologët Kethrin Parr dhe Tom Bishop, sugjeruan se edhe ndryshimi i klimës, njolla e madhe e specieve sonë në planet, mund të mos jetë një fatkeqësi e madhe për milingonat, struktura shoqërore e të cilave do t’i lejojë ato të “kalojnë nga ndryshimet mjedisore” në një shkallë shumë më të madhe sesa organizmat e vetmuar.

Gjë që nuk është e habitshme. Milingonat ishin këtu në Tokë para nesh dhe ka të ngjarë të jenë edhe shumë kohë pas nesh. Ato sundojnë planetin. Ne njerëzit jemi vetëm kalimtarë. / “New York Times” – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Franca, bindëse ndaj Australisë. Meksika barazon me Poloninë

Al Wakrah, 22 nëntor - Franca e nis me këmbën e mbarë aventurën në Kupën e Botës në Katar. Kampionët në fuqi treguan menjëherë forcën e tyre duke shkatërruar 4-1 Australinë. Në fakt ndeshja nuk nisi aspak mirë për skuadrën e Deschamps. Australia do të befasonte "gjelat" në fillimin e ndeshjes. Në minutën e 9-të, australianët përfituan nga një përgjumje e mbrojtjes franceze duke shënuar me Goodwin. Reagimi i Francës nuk do të vononte teksa në harkun e 5 minutave do të shënonte dy gola duke

përmbysur gjithçka. Në të dyja rastet protagonist është Rabiot me gol në të parin dhe me asistim për Giroud në të dytin. Në pjesën e dytë, Franca gjen dy gola të tjerë ndaj Australisë duke i dërguar shifrat tashmë në 4-1. Në minutën e 67-të, Kylian Mbappe realizon me një goditje të bukur me kokë pas një krosimi të ardhur nga krahu i djathtë nga Dembele. Katër minuta më pas ndërkohë do të kishe kohë për një tjetër gol nga Giroud që bën gjithçka mirë me kokë pas një pasimi që mori nga Mbappe. Franca me këtë fitore merr kryesimin e Grupin D

me 3 pikë, e ndjekur nga Danimarka dhe Tunizia me një pikë. Ndërsa në ndeshjen tjetër Robert Lewandowski mund ti kishte dhuruar fitoren Polonisë në ndeshjen e parë të grupit C por sulmuesi i Barcelonës gaboi nga pika e bardhë në minutën e 58', teksa pritja ju bllokua nga veterani Ochua. Sa i përket lojës, ndeshja ishte e barabartë nga të dyja skuadrat ku loja më së shumti u përqëndrua në mesfushë. Në ndeshjen e radhës, Meksika luan ndaj Argjentinës, ndërsa Polonia ndaj Arabisë Saudite.



Arabia Saudite 'shokon' Argjentinën, Danimarka ndalet në barazim



LUSAIL, 22 NËNTOR - Arabia Saudite e ka shkaktuar befasinë e parë në këtë kampionat Botëror, pasi e ka mposhtur Argjentinën me rezultat 1-2. Në pjesën e parë Argjentina ishte skuadër më e mirë dhe arriti të shënojë një gol nga penalltia me anë të Leo Messit, derisa tre gola të tjerë u anuluan për shkak të pozitës jashtë loje. Në pjesën e dytë gjërat ndryshuan dhe Arabia Saudite ishte dukshëm skuadër më luftarake dhe arriti të shënojë dy gola dhe ta përmbysë rezultatit. Shënues ishin Saleh Al Shehri (49') dhe Salem Al Dawsari (54').

Në ndeshjen tjetër që u zhvillua nga ora 14:00 në mes të Danimarkës dhe Tunizisë u regjistrua një barazim pa gola 0-0, në një duel të ndezur dhe shumë të luftuar, por që nuk prodhoi asnjë ekip fitues. Tunizia ishte më e qartë dhe më e rrezikshme në pjesën e parë. Jebali gjeti golin e avantazhit në minutën e 24-t, por ishte dukshëm në pozicion ta parregullt. Disa minuta më vonë Laidouni do të gjente vetëm rrjetën e jashtme, ndërkohe që Jebali përballë portierit nuk arriti të shënonte. Në pjesën e dytë Danimarka "zgjohet",

duke qenë më dominuese në lojë dhe në raste. Andreas Cornelius kishte shansin e artë për ta zhblokuar sfidën, por vetëm fare shumë pranë portës ndalet nga shtylla. Sulmuesi ishte i rrezikshëm dhe në fundin e takimit me një tjetër goditje me kokë, që u ndal nga portieri Dahmen. Portieri i Tunizisë bëri një mrekulli edhe ndaj një goditjeje të Lindstromit. Danimarka pretendoi edhe për një penallti në fund të takimit por gjyqtari, pasi e ndoqi aksionin me VAR, nuk akordoi asgjë.

Përquku, MVP e javës në Superligë



PRISHTINË, 22 NËNTOR - Bashkimi ka shënuar fitore ndaj Penzës në udhëtim, duke vazhduar pa humbje në elitën e basketbollit të femrat. Basketbollistja më e dalluar në parket ishte Arbnore Përquku me dyshifror të trefishtë, 14 pikë, 12 kërcime dhe dhjetë asistime. Përquku zgjidhet MVP e kësaj jave, ndërsa nuk është hera e parë që shpallet më e mira e javës. Ajo u ndihmua nga Taliyah Hopkins me 22 pikë dhe shtatë kërcime. United

Basketball regjistroi fitore shumë të vlefshme ndaj Trepçës, ndërsa sërish më e mira ishte amerikania Ireyon Keith me 19 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime. Prishtina shënoi fitore të pritur dhe bindëse ndaj Vëllaznimit, ku u dalluan dyshja vendore Besjana Martinaj dhe Zërina Shatri. Martinaj e mbylli ndeshjen me 25 pikë, një kërcim dhe pesë asistime, kurse Shatri me dhjetë pikë, 16 kërcime dhe një asistim.

Top pesëshja

- Arbnore Përquku (Bashkimi) 14 pikë, 12 kërcime, 10 asistime
- Taliyah Hopkins (Bashkimi) 22 pikë, 7 kërcime
- Ireyon Keith (United Basketball) 19 pikë, 8 kërcime, 4 asistime
- Besjana Martinaj (Prishtina) 25 pikë, 1 kërcim, 5 asistime
- Zërina Shatri (Prishtina) 10 pikë, 16 kërcime, 1 asistim

Edhe një Evropian në Prishtinë

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka fituar edhe një organizim ndërkombëtar. Bordi i FIBA Evropës ka marrë vendim që Kampionati Evropian, Divizioni C për meshkuj U16, të mbahet në Prishtinë. Kjo garë do të mbahet nga 15 deri më 23 korrik 2023 në kryeqytetin e

Kosovës. Evropiani i Divizionit C këtë vit është mbajtur në Prizren, kurse Challenger për U16 ishte mbajtur në Prishtinë vitin e kaluar. Më herët në Prishtinë është organizuar Evropiani i Divizionit B për femra U18, kurse për herë të parë ishte organizuar Divizioni C për

meshkuj 18, ku kishin fituar "Dardanët", ashtu si edhe Challengerin edicionin e kaluar. Në të gjitha këto organizime, Federata e Basketbollit e Kosovës ka marrë lëvdata për organizime nga FIBA, që dëshmohej edhe me dhënien e organizimeve ndërkombëtare për Kosovën.



Messi pas humbjes nga Arabia Saudite: Kurrë nuk kam marrë një goditje kaq të fortë

DOHA, 22 NËNTOR - Lionel Messi, pas ndeshjes që Argjentina e humbi nga Arabia Saudite (1-2), është shprehur i zhgënjyer me disfatën, duke thënë se ka qenë goditje e cila nuk i ka ndodhur

më parë. "Gabimet brenda pesë minutave na kushtuan me rezultatin 2-1. Ne u ngatërruam dhe pas golave gjërat u komplikuan edhe më shumë. Nuk ka arsytetime për golat që

nuk na i pranuan, pasi ishin në pozitë jashtë loje. E kemi ditur se Arabia Saudite është një ekip që, nëse e lejon të luajë, do të shkaktojë telashe. Ata luajtën shumë mirë", ka deklaruar

Messi. "Kurrë nuk kam marrë një goditje kaq të fortë me këtë grup lojtarësh. Gjërat ndodhin për një arsye. Tani padyshim se duhet t'i fitojmë dy ndeshjet e tjera", ka shtuar Messi.



Dhjetë trajnerët më të paguar në Kupën e Botës



DOHA, 22 NËNTOR - Kupa e Botës në Katar ka filluar tashmë me ndeshjet e para dhe golat e parë. Nuk kanë munguar befasitë në ditët e para të Botërorit. Për këtë mjafton ta pyesim Argjentinën e Leo Messit. Në këto orë flitet edhe për trajnerët dhe, në këtë rast, për rrogat e tyre. "Sport.es" ka publikuar listën e trajnerëve të kombëtareve duke bërë renditjen e më të paguarve. Mes dhjetë të parëve bie në sy trajneri i Gjermanisë, Hansi Flick, i cili kryeson ndaj kolegëve. Në podium është edhe trajneri Southgate i Anglisë, në vendin e dytë. Në vendin e fundit të podiumit pozicionohet trajneri i kampioneve të botës në fuqi,

Didier Deschamps. Mungojnë në apel trajneri i Belgjikës, Roberto Martinez (1.2 milionë), Luis Enrique i Spanjës dhe Kasper

Hjulmand i Danimarkës (1.15 milion). Më pak i paguari nga të gjithë trajnerët është Jalel Kadrid (Tunizia) me 130 000 euro.

LISTA E TRAJNERËVE:

1. Hansi Flick	(Gjermani)	6.5 milionë
2. Gareth Southgate	(Angli)	5.8
3. Didier Deschamps	(Francë)	3.8
4. Tite	(Brazil)	3.6
5. Louis van Gaal	(Holandë)	2.9
6. Gerardo Martino	(Meksikë)	2.9
7. Lionel Scaloni	(Argjentinë)	2.6
8. Felix Sanchez	(Katar)	2.4
9. Fernando Santos	(Portugalia)	2.25
10. Murat Yakin	(Zvicër)	1.6

Bostoni ndalet pas 9 fitoresh, triumfojnë clippersat dhe Milwaukee

CHICAGO, 22 NËNTOR - Pas nëntë fitoresh radhazi, ndalet skuadra e Bostonit, që u mund me rezultat 121-107 nga Chicago, një sfidë mes dy ekipeve rivale në Lindje. DeRozan me 28 pikë e LaVine me 22 pikë bënë dallimin në parket për Bulls, duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Tatumit për Celticsin. Fiton edhe Cleveland, që mundi me rezultat 114-102 Atlanta, ndeshje ku u dalluan Mitchell me 29 pikë e Garlandi me 26. Tjetër humbje për skuadrën kampione të Golden States, që u mund me



rezultat 128-83 nga New Orleansi. Mungesa e Curryt dhe Thompsonit u ndje te Warriors, ndërsa për New Orleansin u dallua Ingram me 34 pikë. Skuadra e clippersave, falë 20 pikëve të Powellit dhe 27 të Jacksonit, mundi me rezultat 121-114 Utah Jazzin. Skuadra e Milwaukeees, falë 37 pikëve të

Antetokounmpos, mundi Portlandin (119-111), ndërsa Miami u mposht me shifrat 105-101 nga Minnesota, ndeshje ku u dalluan Townsi me 25 pikë e Edwardsi me 22. Fiton edhe Indiana, që mundi 123-102 Orlandon, me Mathurin protagonist, autor i 22 pikëve.

REZULTATET

Cleveland - Atlanta	114-102
Indiana - Orlando	123-102
Chicago - Boston	121-107
Milwaukee - Portland	119-111
Minnesota - Miami	105-101
New Orleans - Golden S.	128-83
Oklahoma - New York	119-129
Clippers - Utah Jazz	121-114

SHKURT

Zidane do të jetë trajner i Francës nga 1 janari

Zinedine Zidane do të jetë trajner i Francës duke filluar nga 1 janari 2023. Tekniku francez nuk ka trajnuar një ekip që nga maji i vitit 2021 kur përfundoi aventurën e tij në krye të Real Madridit. Kështu mediet spanjolle thonë se Zidane do ta plotësojë ëndrrën për të drejtuar kombin e tij. Zidane është përfolur shumë se do të jetë në krye të Francës dhe tashmë që afrohet janari, bëhet edhe më shumë e zhurmshme fjala se ai do ta drejtojë kombin e tij në trofetë e ardhshëm.

Gjermania humbet Sanen për ndeshjen debutuese

Gjermania po përgatitet për duelin hapës të Botërorit kundër Japonisë. Strategu Hansi Flick ka marrë një lajm të keq në prag të ndeshjes. Në seancën e paradites nuk ka marrë pjesë ylli i sulmit, Leroy Sane. Anësori i Bayern Munchenit ka një dëmtim në gju dhe kjo është njoftuar nga Federata Gjermane e Futbollit, që nuk zbulon më shumë detaje. Sane nuk mund të luajë ndaj Japonisë. Gjermania është pjesë e Grupit E në "Katar 2022", ku do të garojë edhe me Spanjën, Kosta-Rikën dhe Japoninë.

Guardiola vazhdon kontratën me Cityn

Tekniku spanjoll Pep Guardiola ka rinovuar kontratën me skuadrën e Manchester Cityt. Trajneri spanjoll ka rënë dakord për një kontratë të re që do ta mbajë atë te City deri në vitin 2025, ka raportuar gazetari David Ornstein. 51-vjeçari ka marrë drejtimin e Cityt nga viti 2016, ekip me të cilin ka arritur të fitojë plotë nëntë trofe.

Atletico, gati ta lë Felixin të largohet

Atletico Madridi është gati ta lërë të largohet në formë huazimi sulmuesin Joao Felix. Lojtari është i pakënaqur te "Los Colchoneros". Sipas asaj që bën me dije "AS", lojtari është duke ia "shkelur" syrin Manchester Unitedit, që me largimin e Cristiano Ronaldos në janar, synon të gjejë menjëherë një zëvendësues. Mbetet të shihet se çka do të ndodhë në këtë afat kalimtar.

Chisora kërcënon Furyt: Këtë herë e mposhti

Boksieri britanik Dereck Chisora mendon se në përballjen e 3 dhjetorit ndaj Tyson Furyt mund të fitojë dhe të shpallet kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC). Kjo do të jetë sfida e tretë mes dy boksierëve britanikë, me Furyt që i ka fituar dy përballjet e mëparshme. Kjo sfidë e tretë do të zhvillohet në stadiumin e Tottenhamit në Londër. Chisora, 33 fitore e 12 humbje, ka deklaruar: "Unë nuk e di se si do të jetë Tysoni në ring, kanë kaluar 8 vjet nga hera e fundit që kemi dueluar së bashku. Ai është një boksier i mirë dhe ngacmues në ring. Do të jetë një sfidë e madhe dhe dua të fitoj me KO. Unë e kam aftësinë për ta mposhtur Furyt". Në fund, Chisora ka vlerësuar Furyt si njeri e boksier, që pak vite më parë kaloi në depresion. "Jeta është e mrekullueshme. Tysoni është një luftëtar i madh. Ai shkoi në depresion, në krizë dhe arriti ta kalojë atë vështirësi dhe ka dëshmuar se të gjithë e kanë gabim. Duhet t'i heqësh kapelën kur njerëzit bëjnë mirë", ka deklaruar Chisora.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Azem Abdylaga shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I - III shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Simon Shtufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.

- Skender Kolloni shpall të pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Naim Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Orhan Baxhaku shpall të pavlefshme certifikatën ahmlt "11 Marsi " Prizren.

- Arsim Qehaja shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- KFF EP Hajvalia SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811579509.

- Musa Hoti nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga kl. VI-IX të SH.F. "Haxhi Hoti" Rogovë.

- Sanije Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës Fillore "Shaban Golaj" Lipovec KK Gjakovë.

- Endrit Shabani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

